

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup të Operatorëve Ekonomik: “VLERA” Sh.p.k. & “EKO DEZZ” D.o.o. adresë në Shtime Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi – U.d. Menaxher i Prokurimit – Komuna e Rahovecit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	18.06.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për ri-shqyrtim** të datës: 16.06.2019, të parashtruar nga **Grup të Operatorëve Ekonomik: “VLERA” Sh.p.k. & “EKO DEZZ” D.o.o. adresë në Shtime**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DEZINSEKTIM, DEZINFEKTIM DHE DERATIZIM**, me Numër të prokurimit: **623-19-3485-2-2-1**, Nr i brendshëm: **623-19-024-2-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup të Operatorëve Ekonomik: “VLERA” Sh.p.k. & “EKO DEZZ” D.o.o. adresë në Shtime, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DEZINSEKTIM, DEZINFEKTIM DHE DERATIZIM**, me Numër të prokurimit: **623-19-3485-2-2-1**, Nr i brendshëm: **623-19-024-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 13.06.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autortieti Kontraktues vendos të vazhdoj Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **DEZINSEKTIM, DEZINFEKTIM DHE DERATIZIM**, me Numër të prokurimit: **623-19-3485-2-2-1**, Nr i brendshëm: **623-19-024-2-2-1**, dhe mbështetë Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup të Operatorëve Ekonomik: “VLERA” Sh.p.k. & “EKO DEZZ” D.o.o. adresë në Shtime, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DEZINSEKTIM, DEZINFEKTIM DHE DERATIZIM**, me Numër të prokurimit: **623-19-3485-2-2-1**, Nr i brendshëm: **623-19-024-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 13.06.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 13.06.2019, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042, në cilin pretendon se janë shkelur këto nenet:

- **Neni 59** Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve
- **Neni 61** Tenderët Jo-normalisht të Ulët
- **Neni 69** Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- **Neni 5** i Udhezimi Administrativ Nr. 04/2015-KRPP: Refuzimi i tenderëve jo-normalisht të Ulët për shkak të mos respektimit të ligjeve që ka të bëjnë me ligjet dhe rregullat e punësimit dhe kushtet e punës.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

Pretendimi i OE: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve dhe Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik:

Autoriteti Kontraktues ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve të gjitha dokumenteve të prezantuara në ofertat e pranuar.

Gjatë Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahاسimit të Tenderëve, Grup i Operatorëve Ekonomik: **“SAMIRE OSMANI” B.I. & N.T.P. “BENI”** me adresë në **Suharekë**, i shpallur si fitues i kësaj procedure, ju Njoftojm se i plotëson të gjitha Kushtet sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit: **Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT)** dhe është Tenderuesi i përgjegjshëm me çmim më ulët.

Pretendimi i OE: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 61 (Tenderët jo-normalisht të ulët) të Ligjit për Prokurimin Publik

Ju njoftim se A.K. Komuna e Rahovecit ka respektuar nenin 61.1 të LPP – së “Tenderët Jo-Normalisht të Ulët”.

Neni 3

Informatat e përgjithshme

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të **gjitha kushtet e mëposhtme:**

- i. çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;**
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;**
- iii. janë dorëzuar të paktën **3 (tre) tenderë.**

Oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomik: “SAMIRE OSMANI” B.I. & N.T.P. “BENI” me adresë në Suharekë, nuk i plotëson këto tri (3) kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhojë nuk mund të konsiderohet si oferte abnormalisht e ulët.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
U.d. Menaxher i Zyres së Prokurimit
Komuna e Rahovecit